

Roland Shira

MBRETËRIA E DREJTSHKRIMIT

përrallë

Ilustrimet: Gea Qëndro

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Arta Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN: 9789928960276

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com


toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Sime bije, Aris Shira



Ky libër është një udhëtim i gjatë në botën e fjalëve, ku gërmat kanë zë, fjalët kanë flatra dhe librat përçojnë mençuri. Është një përrallë që nuk ka princa, mbretër e oborrtarë të zakonshëm, por germa, zanore e bashkëtingëllore, shenja pikësimi, thonjëza e viza që udhëtojnë së bashku. Qëllimi i librit është të na ndërgjegjësojë për drejtshkrimin e gjuhës shqipe.





Në një vend të largët, përtej maleve
të bardha dhe liqeneve blu, shtrihej
një mbretëri e çuditshme. Ajo quhej
Mbretëria e Drejtshkrimit të Gjuhës
Shqipe. Aty sundonte një mbret që i
donte shumë oborrtarët: shkronjat, fjalët,
fjalitë, shenjat e pikësimit, secila me një shpirt
të vetin dhe me një rol të shenjtë.

Në qendër të Mbretërisë ngrihej një kështjellë
e madhe prej librash. Muret e saj ishin fletë të
shkruara kurse çatitë kapakë librash. Në majë të
një kulle të lartë valëvitej një flamur ku shkruhej: